



N. 291 Prot.

Tiranë më, 19/8/2024

NJOFTIM PËR PRANIM
PROGRAM I STUDIMIT MASTER UNIVERSITAR I NIVELIT TË PARË /MASTER PROFESIONAL
NË
FINANCIAL & RISK MANAGEMENT
Viti akademik. 2024 -2025

Programi i Studimit Master Universitar i Nivelit të Parë/Master Profesional në “*Financial & Risk Management*” ka një kohëzgjatje një vjeçare dhe zhvillohet në *gjuhën angleze*. Ky program zhvillohet në mënyrë të përbashkët me Alma Mater Studiorum – Universiteti i Bolonjës dhe finalizohet me lëshimin e diplomës së përbashkët nga të dy Universitetet.

Kuotat e disponueshme dhe kushtet e pranimit

Për vitin akademik 2024-2025, në Programin e Studimit Master Universitar i *Nivelit të Parë/Master Profesional* në “*Financial & Risk Management*”, janë të disponueshme gjithsej 35 vende për kandidatët shqiptarë, 10 për kandidatë të huaj dhe 5 për kandidatë nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci, Medvegja.

Për tu pranuar në Programin e Studimit Master Universitar i *Nivelit të Parë/Master Profesional* në “*Financial & Risk Management*” kandidatët duhet të kenë të paktën një Diplomë trevjeçare/Bachelor në programe studimi të akredituara në kohën e lëshimit dhe të kryera në Universitete gjithashtu të akredituara institucionalisht në Vendin e Origjinës në kohën e lëshimit, përkatësisht në programet:

- Administrim dhe Menaxhim
- Shkenca ekonomike dhe administrim biznesi;
- Shkenca ekonomike dhe statistikore;
- Shkenca matematikore;
- Shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare;
- Fakultete të tjera që vlerësohen të përshtatshme nga Komisioni;

Mënyra e pjesëmarrjes

Për të paraqitur kërkesën për pranim, kandidatët duhet të plotësojnë procedurën e regjistrimit online në portalin e Universitetit Katolik ZKM: <http://admissions.unizkm.al/> brenda datës **04/10/2024**, duke bashkëngjitur një kopje elektronike në formatin PDF (skanim pdf/A) të dokumentacionit të mëposhtëm:

- a. Diplomë Bachelor
- b. Vërtetim i Diplomës me listën e notave të lëshuar nga Universiteti nga vjen;
- c. Çdo kualifikim tjetër i vlerësueshëm (kurse specializimi, kurse gjuhe, Master, etj.)
- d. Curriculum Vitae (CV) e nënshkruar.
- e. Dokument i vlefshëm identifikimi (pasaportë ose kartë identiteti).
- f. Foto personale.
- g. Deklarata sipas Shtojcës nr. 1, pjesë përbërëse dhe bashkëngjitur këtij Njoftimi.



- h. Vërtetim¹ i nivelit B1 të gjuhës angleze të lëshuar nga një institucion i njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (Cambridge, IELTS, TOEFL, TOEIC, GESE, APTIS).

Kandidatët e huaj pas dorëzimit të dokumenteve të listuara më sipër, duhet të kryejnë **brenda datës 08/10/2024** pagesën e shumës prej 50 euro për regjistrim² si më poshtë:

- përmes një transferte bankare³ me koordinatat e mëposhtme:
Përfitues: Zoja e Këshillit të Mire (Universiteti Katolik)
Banka: Intesa San Paolo Bank
BIC/Swift: USALALTR
IBAN: AL60208112040000030694935302
- me kartë krediti online në portalin universitar: <http://admissions.unizkm.al/>;
- duke paguar *cash* pranë Zyrës së Pranimeve të Universitetit e disponueshme nga e hëna në të premtë, nga ora 08:00 deri në 16:30.

Kandidatët shqiptarë dhe shtetasit nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi etj. të cilat pas dorëzimit dhe verifikimit të dokumentacionit konsiderohen të përshtatshëm, duhet të kryejnë **brenda datës 08/10/2024**, pagesën e regjistrimit prej 2.000 lekë;

Pagesa bëhet në të njëjtën mënyrë siç u përmend më sipër.

Statusi i regjistrimit tuaj mund të kontrollohet duke hyrë në zonën tuaj të rezervuar në portalin e Universitetit .

Mënyra e përzgjedhjes

Kandidatët do të listohen në bazë të dokumentacionit të paraqitur.

Në rast se numri i kandidatëve do të jetë më i lartë se kuotat e parashikuara, do të zhvillohet një intervistë motivuese dhe një test për Gjuhën Angleze që do të mbahet në datë **11/10/2024**, pranë Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” në Rr. “Dritan Hoxha”, Tiranë, Shqipëri.

Rezultatet e intervistës do të publikohen në faqen zyrtare të Universitetit Katolik ZKM: <https://www.unizkm.al/> **brenda datës 18/10/2024**.

Regjistrimi

Për t'u regjistruar, kandidatët që do të shpallen fitues në bazë të rezultateve dhe kuotave të disponueshme, duhet të dorëzojnë pranë Sekretarisë Mësimore, personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi të autorizuar, **më datë 27/10/2024** dokumentet e mëposhtme në format letër:

¹ Kandidatët që kanë një diplomë në një nga programet e studimit e sipërpërmendura dhe e kanë kryer në të njëjtën gjuhë të huaj që do të zhvillohet edhe programi i *Masterit profesionale në “Financial & Risk Management”*, nuk nevojitet të paraqesin Vërtetimin e njohjes së gjuhës së huaj, siç parashikohet dhe në Pikën 4 Neni 76, Ligji nr. 80/2015, i datës 22.07.2015 i Republikës së Shqipërisë”. Kandidatë të cilët në momentin e dorëzimit të kërkesës për pranim nuk disponojnë vërtetimin e njohjes së gjuhës angleze ose një diplomë në përputhje me nenin e sipërpërmendur të ligjit, do t'i nënshtrohen një testi njohjeje të gjuhës angleze.

² Çdo komision i mundshëm i ngarkohet kandidatit. Tarifat duhet të mbërrijnë të plota në llogarinë bankare të Universitetit përndryshe regjistrimi bëhet i pavlefshëm.

³ Ju lutemi të specifikoni në Urdhër pagesë emrin dhe mbiemrin si dhe programin/et e studimit/eve për të cilin/at kryhet pagesa. Ditën e intervistës duhet të paraqisni kopjen e urdhër pagesës pasi koha e akreditimit është e limituar.



1. Faturën e pagesës bankare (fletëpagesa mund të shkarkohet nga portali studentor i universitetit: portal.unizkm.al, zëri: Tarifat);
2. Diplomën, dhe listën e notave/suplementit të diplomës, ose një kopje në përputhje me origjinalin, të ciklit të Parë të studimeve të kryer në Republikën e Shqipërisë. Diplomën e I ciklit të Parë të studimeve të kryer jashtë shtetit, të pajisur me një kopje konform origjinalit, ose, nëse nuk e posedon, dorëzon një dokument tjetër zyrtar mbi bazën e të cilit është bërë njehsimi në Republikën e Shqipërisë, të lëshuar në vendin ku ka kryer studimet, i cili i mundëson regjistrimin dhe ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë. Kandidatët që nuk kanë përfunduar ende procesin e njohjes dhe njehsimit të diplomës, paraqesin vërtetimin e kërkesës për pranim pranë QSHA për njohje dhe njehsim.
3. Formularin e dorëzimit të aplikimit për pranim (referuar Shtojcës n.2 bashkëlidhur këtij Njoftimi)
4. Kopje e dokumentit të identifikimit;
5. Dy foto personale.
6. Çdo kualifikim tjetër i vlerësueshëm (kurse specializimi, kurse gjuhe, Master, etj.)
7. Vërtetim⁴ i nivelit B1 të gjuhës angleze të lëshuar nga një institucion i njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (Cambridge, IELTS, TOEFL, TOEIC, GESE, APTIS).
8. Vetëm për kandidatët që kanë marrë diplomën jashtë shtetit: Dokumenti i njehsimit⁵ të diplomës lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore të Republikës së Shqipërisë, origjinali ose kopja e noterizuar. Siç parashikohet në Urdhrin e Përbashkët të RASH dhe QSHA n. 112 i datës 05/07/2024 ekziston detyrimi për paraqitjen e këtij dokumenti **brenda datës 30/03/2025**.

Në rastet kur dokumentacioni vjen nga një universitet i huaj, dokumentacioni duhet të ketë vulën apostile të vendit të origjinës. Gjithashtu, nëse dokumentacioni i kërkuar nga një Universitet i huaj nuk është në shqip/anglisht/italisht, ai duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe..

Kandidatët të cilët nuk respektojnë afatet dhe mënyrat e mësipërme të regjistrimit mund të regjistrohen *me rezervë* por nuk do të mund t'i nënshtrohen provimeve të semestrit të parë, derisa të rregullojnë pozicionin e tyre. Regjistrimi *me rezervë* pengon marrjen e statusit të studentit dhe për rrjedhojë, e bën të pamundur pretendimin e ndonjë gjëje kundër Universitetit Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”.

Pranë Sekretarisë Mësimore do të plotësohen gjithashtu:

- Formulari i aplikimit (formular i disponueshëm në portalin universitar: <https://portal.unizkm.al/#/>);
- Kontrata e regjistrimit.
- Deklarata sipas Shtojcës n.1 pjesë përbërëse bashkëlidhur Dekretit nr. 12 del 30.06.2023.

⁴ Kandidatët që kanë një diplomë në një nga programet e studimit e sipërpërmendura dhe e kanë kryer në të njëjtën gjuhë të huaj që do të zhvillohet edhe programi i *Masterit profesionale në “Financial & Risk Management”*, nuk nevojitet të paraqesin Vërtetimin e njohjes së gjuhës së huaj, siç parashikohet dhe në Pikën 4 Neni 76, Ligji nr. 80/2015, i datës 22.07.2015 i Republikës së Shqipërisë”. Kandidatë të cilët në momentin e dorëzimit të kërkesës për pranim nuk disponojnë vërtetimin e njohjes së gjuhës angleze ose një diplomë në përputhje me nenin e sipërpërmendur të ligjit, do t'i nënshtrohen një testi njohjeje të gjuhës angleze.

⁵ Informacionet mbi mënyrën e marrjes së dokumentit të njehsimit për diplomën e studimeve universitare të kryera më parë gjendet në faqen:

<https://unizkm.al/>

<https://unizkm.al/uploads/media/post/0001/05/68b2ce536b6d5bc8ad88d085a1f056f115ff25e6.pdf>



Numri minimal i pjesëmarrësve

Për hapjen e programit Master duhet të arrihet një numër *minimal pjesëmarrësish* 16 të regjistruar. Nëse ky numër nuk arrihet, Universiteti ka të drejtën të mos hap programin, duke u kthyer të regjistruarve çdo tarifë që kanë paguar.

Rektori
Prof. Leonardo Palombi

